



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 324/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19/05/2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit KVO-së për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Alb Building” shpk në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me objekt “Rikonstruksioni i rruges Fushe Kruje-Thumane” me Nr. REF-66979-02-08-2017 me fond limit 741.333.333 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 03.03.2017 nga autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Ankimues:

Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë
“Bami” shpk & “Geci” shpk
Adresa: Lagjia “Kameras” Fushë- Krujë, ose
Rruga “Mine Peza”, Pallati i ri P78/1 ngjit me shkollën
“Hasan Vogli”, kati i dytë, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Adresa: Rr “Sami Frashëri” Nr.10
Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:**I**

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Bashkimi i operatorëve ekonomik kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili e ka refuzuar atë, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”;

I.3. Kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II***Rrethanat e çështjes***

II.1. Në datën 08.02.2017 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me objekt “*Rikonstruksioni i rruges Fushe Kruje-Thumane*”

me Nr. REF-66979-02-08-2017 me fond limit 741.333.333 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 03.03.2017 nga autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

II.2 . Në datën 03.03.2017 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrative rezulton se në datën 23.03.2017, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

i.	“Alb- Building” shpk	538,226,327	lekë	kualifikuar;
ii.	“Gener 2” shpk	558,892,318	lekë	skualifikuar;
iii.	“Viktoria Invest International” shpk	577,924,211	lekë	skualifikuar;
iv.	“Delta Lavori” shpk	582,390,748	lekë	skualifikuar;
v.	“Gjoka Konstruksion” shpk	598,601,848	lekë	skualifikuar;
vi.	“Vuthaj” shpk	622,561,200	lekë	skualifikuar;
vii.	“AlbStar” shpk	625,517,778	lekë	skualifikuar;
viii.	“Alko Impex General Construction” dshh	648,807,264	lekë	skualifikuar;
ix.	“Arifaj” shpk	652,808,814	lekë	skualifikuar;
x.	“Bami” shpk	704,324,888	lekë	kualifikuar;
xi.	“Fusha” shpk	725,261,351	lekë	skualifikuar
xii.	“A.N.K.” shpk	730,266,630	lekë	skualifikuar;
xiii.	“Varaku E”	nuk ka paraqitur ofertë		

II.4. Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, parashtrimeve me shkrim të ankimuesit dhe informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se në datën 30.03.2017, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “AlbBuilding” shpk në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.4.1. Në ankesën drejtuar autoritetit kontraktor, pala ankimuese kundërshton vendimin e KVO-së me argumentat se: “[...]Nga të dhënat që disponojmë rezulton se, operatori i kualifikuar dhe i

renditur në vendin e parë “Albbuilding” shpk nuk plotëson kërkesat e dhëna në dokumentat e tenderit dhe është kualifikuar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik. Mangësitë e këtij operatori janë si më poshtë vijon:

- i. Në kundërshtim me pikën 2.3.1. të kriterëve të veçanta të kualifikim- 2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të ketë realizuar punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50% e vlerës së fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë tri viteve të fundit, është jo më pak se 200% e vlerës së fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Plotësimi i njërit prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Për të vertetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë formularët e vlerësimit sipas shtojcës përkatëse të DST të shoqëruar me kontratën/kontratat e nënshkruara nga palet, situacionet perfundimtare, aktet e kolaudit dhe faturat tatimore përkatëse. Operatori ekonomik i kualifikuar në vendin e parë nuk i ka të rregullta të gjitha dokumentet e kërkuara për punën e ngjashme.
- ii. Në kundërshtim me pikën 2.3.7. të kriterëve të veçanta për kualifikim -Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo cdoganimit, fotot dhe fatura tatimore përkatëse. Kur janë me qera, duhet të paraqitet kontrata e qerës, kontrata e blerjes apo cdoganimit, fotot dhe fatura tatimore përkatëse. Operatori ekonomik i kualifikuar në vendin e parë nuk i ka të gjitha kapacitetet teknike të kërkuara dhe nuk disponon të gjithë dokumentacionin e kërkuar për këto kapacitete.
- iii. Në kundërshtim me pikën 2.3.8. të kriterëve të veçanta për kualifikim- Makineritë e mesiperme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera. Për këtë të paraqitet një deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese se makineritë e mesiperme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.- Operatori ekonomik i kualifikuar në vendin e parë sipas dëgjimit të tij nuk i ka të angazhuara në kontrata të tjera. [...]”

II.5. Në datën 05.04.2017 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.305/1 prot datë 05.04.2017 i kthen përgjigje palës ankimese duke mos pranuar ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomik.

II.5.1. Në kthim përgjigje autoriteti kontraktor argumenton në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon: “[...] Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vëren se: Ankimesi kërkon skualifikimin e operatorit ekonomik “Alb Building” shpk (operatorit të kualifikuar me ofertë më të ulët), pasi hedh dyshime për parregullsi në dokumentat e paraqitura dhe mos plotësim të kriterëve për kualifikim, por nuk jep asnjë informacion, argument ligjor ose provë që të provojë pretendimet e ngritura, siç përcaktohet në nenin 78 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Ankimesi për të provuar pretendimin e tij ka dhënë vetëm opinione të vetat të cilat nuk i mbështet në fakte e prova sikurse dhe e kërkon ligji. Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e aneksave gjykon se është detyrim i operatorit ekonomik

ankimues që të provojë pretendimin e parashtruar para Autoritetit Kontraktor duke paraqitur prova apo argumenta bindëse, të cilat mbështesin ankesën, objekt shqyrtimi” [...]”

II.7. Në datën 14.04.2017 bashkimi i operatorëve ekonomik ankimes ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II.7.1. Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, parashtrimeve me shkrim dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, KPP, konstaton se ankimesi ka shtuar objektin e ankimit pranë KPP-së duke ngritur pretendime të reja shtesë në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon: “ [...]

- i. *“Referuar Licencës profesionale të shoqërisë “Alb Building” shpk rezulton që është drejtues ligjor Odhise Bresha, ndërsa sipas ekstraktit të QKB-së rezulton drejtues ligjor Odhise Bresha dhe z. Pëllumb Beta. Kjo është në kundështrim me rregulloren për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimi, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi e miratuar me VKM nr.42 datë 16.01.2008 kreu II, pika 5*
- ii. *Sipas licencës profesionale të shoqërisë rezulton që drejtuesit teknik të saj z. Arjan Beqiraj, z. Robert Koçi dhe z. Sami Taka nuk janë të punësuar me kohë të plotë, por me kohë të pjesshme. Ky fakt mund të vërtetohet lehtësisht nga ana juaj nga të dhënat e formularit E-Sig 025 “Listëpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi” të paraqitura nga subjekti për periudhën e kërkuar. Kjo bie në kundërshtim me “Kriteret e Përgjithshme të pranimit/kualifikimit” pika 2 të DST ku përcaktohet se subjekti duhet të ketë paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore”. Gjithashtu kjo bie në kundërshtim edhe me rregulloren për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi e miratuar me VKM nr.42 datë 16.01.2008, Kreu III pika 9/c.....*
- iii. *Sipas të dhënave që disponohen nga ana jonë rezulton që nga operatori ekonomik është shkelur VKM nr.742 date 06.11.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.692 datë 12.12.2001 të Këshillit të Ministrave “Për masate veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes të shëndetit në punë pika 12/2.....Mjeku i kontraktuar është në kundërshtim dhe me dokumente tenderit ku kërkohet që Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij nga nëntori 2016 e në vazhdim mjekun e shoqërisë në zbatim të VKM 742 datë 06.11.2003. Për këtë duhet të paraqesë kontratën e punës dhe diplomën. Në dijeninë tonë, kjo kompani ka kontraktuar një mjek në muajin janar 2017, minimalisht kjo në kundërshtim me kriteret e dhëna në dokumentat e tenderit”*
- iv. *Po ky subjekt nuk disponon asnjë mjet grejder sipas kushteve të dhëna në dokumentat e tenderit ku përcaktohet që “ Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikatë e vlefshme kontrolli teknik, siguracion i vlefshëm i mjetit dhe fotot e tyre”*

Theksojmë faktin që grejderat janë mjete mbi goma që shënohen në regjistrat publikë dhe në bazë të ligjit duhet të jenë të pajisur me të gjitha dokumentat shoqëruese të mësipërme, në të kundërt ky kusht nuk plotësohet.

Gjithashtu, KPP konstaton se në lidhje me kundërshtimet parashtruar pranë autoritetit kontraktor mbi dëshminë e eksperiencës së ngjashme, ankimuesi, në ankesën dorëzuar pranë KPP-së ndër të tjera ka deklaruar se: *“Në dijeninë tonë, ky subjekt ka kryer punime të shkëputura të ndara në objekt me një kompani të huaj, kontraktuar nga ish Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve (Sot Autoriteti Rrugor Shqiptar). Kompania AlbBuilding nuk ka qenë nënkontraktor i njohur i ligjshëm. Aq më tepër nëse bëhet fjalë për punime mbi vlerën 1,482,666,666 lekë pa TVSH kemi dyshime të arsyeshme që nëse bëhet fjalë për punime në këtë objekt ato janë të dhëna të rreme me qëllim kualifikimi. Kujtojmë faktin që ky operator është skualifikuar vitin e kaluar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit për krierin punë të ngjashme pasi ka paraqitur këtë objekt. Po kështu për këtë objekt nuk është paraqitur akt kolaudimi të objektit “Taking Over” si kusht kryesor që duhet të shoqërojë formularin e vlerësimit. Në vijim konstatohet që formulari i lëshuar nga autoriteti kontraktor nuk përcakton përqindjen e kryer nga nënkontraktori, pasi në këtë rast do të vihej në dijeni për të dhëna të rreme që deklarohen nga ky i fundit. Në këto kushte duket qartë që ky operator nuk plotëson këtë kriter kryesor të kërkuar në dokumentet e tenderit.”*

Në lidhje me pretendimin mbi angazhimin e makinerive, KPP konstaton se në lidhje me kundërshtimet parashtruar pranë autoritetit kontraktor, në ankesën dorëzuar pranë KPP-së ankimuesi ndër të tjera ka deklaruar se *“ Sipas kriterit të dhënë në DST duhet që makineritë e kërkuara nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera. Për këtë të paraqitet një deklaratë nga administrator i shoqërisë ofertuese se makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera. Sipas të dhënave që diponohen nga ana jonë, makineritë janë tërësisht të angazhuara në kontrata që subjekti ka tashmë me OSHE-në etj. Pra kemi të bëjmë me deklarime të rreme.*

Gjithashtu, referuar parashtrimeve me shkrim pranë Komisionit të Prokurimit Publik, KPP konstaton se ankimuesi nuk ka parashtruar pretendime të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor në të cilin ka parashtruar argumentin se *“Në kundërshtim me pikën 2.3.7. të kriterëve të veçanta për kualifikim -Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo cdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese. Kur janë me qera, duhet të paraqitet kontrata e qerese, kontrata e blerjes apo cdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese. Operatori ekonomik i kualifikuar në vendin e parë nuk i ka të gjitha kapacitetet teknike të kërkuara dhe nuk disponon të gjithë dokumentacionin e kërkuar për këto kapacitete.”*

II.8. Në datën 18.04.2017 autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacionin e kërkuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues (*thema decidendum*), referuar materialeve të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, parashtrimeve me shkrim të ankimuesit dhe informacionit të autoritetit kontraktor, KPP konstaton se krahas dorëzimit të formularit të ankesës drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues ka dorëzuar gjithashtu edhe Formularin e Ankesës dorëzuar pranë Autoritetit Kontraktor i cili është i njëjtë me Formularin dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dorëzuar nga ky i fundit, pjesë e informacionit, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ. Referuar formularit të ankesës dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik krahasuar me pretendimet parashtruar pranë autoritetit kontraktor, KPP konstaton se nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, në ankesën dorëzuar pranë KPP-së janë parashtruar katër pretendime shtesë mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “AlbBuilding” shpk, të cilat nuk janë parashtruar pranë autoritetit kontraktor në fazën e parë të ankimit administrativ. Pretendimet paraqiten si më poshtë vijon: *“Referuar Licencës profesionale të shoqërisë “Alb Building” shpk rezulton që është drejtues ligjor Odhise Bresha, ndërsa sipas ekstraktit të QKB-së rezulton drejtues ligjor Odhise Bresha dhe z. Pëllumb Beta. Kjo është në kundërshtim me rregulloren për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimi, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi e miratuar me VKM nr.42 datë 16.01.2008 kreu II, pika 5*

ii. *Sipas licencës profesionale të shoqërisë rezulton që drejtuesit teknik të saj z. Arjan Beqiraj, z. Robert Koçi dhe z. Sami Taka nuk janë të punësuar me kohë të plotë, por me kohë të pjesshme. Ky fakt mund të vërtetohet lehtësisht nga ana juaj nga të dhënat e formularit E-Sig 025 “Listëpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore , shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi” të paraqitura nga subjekti për periudhën e kërkuar. Kjo bie në kundërshtim me “Kriteret e Përgjithshme të pranimi/kualifikimit” pika 2 të DST ku përcaktohet se subjekti duhet të ketë paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore”. Gjithashtu kjo bie në kundërshtim edhe me rregulloren për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi e miratuar me VKM nr.42 datë 16.01.2008, Kreu III pika 9/c.....*

iii. *Sipas të dhënave që disponohen nga ana jonë rezulton që nga operatori ekonomik është shkelur VKM nr.742 date 06.11.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.692 datë 12.12.2001 të Këshillit të Ministrave “Për masate veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes të*

shëndetit në punë pika 12/2.....Mjeku i kontraktuar është në kundërshtim dhe me dokumente tenderit ku kërkohet që Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij nga nëntori 2016 e në vazhdim mjekun e shoqërisë në zbatim të VKM 742 datë 06.11.2003. Për këtë duhet të paraqesë kontratën e punës dhe diplomën. Në dijeninë tonë, kjo kompani ka kontraktuar një mjek në muajin janar 2017, minimalisht kjo në kundërshtim me kriteret e dhëna në dokumentat e tenderit”

iv. *Po ky subjekt nuk disponon asnjë mjet grejder sipas kushteve të dhëna në dokumentat e tenderit ku përcaktohet që “ Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikatë e vlefshme kontrolli teknik, siguracion i vlefshëm i mjetit dhe fotot e tyre” Theksojmë faktin që grejderat janë mjete mbi goma që shënohen në regjistrat publikë dhe në bazë të ligjit duhet të jenë të pajisur me të gjitha dokumentat shoqëruese të mësipërme, në të kundër ky kusht nuk plotësohet.”*

III.1.1. Në nenin 63, pika 1, e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, me titull “*Të drejtat e personit të interesuar*” parashikon se: “Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”

Në nenin 63 pika 2 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*” të ndryshuar parashikohet se “*Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.*”

III.1.2. Referuar *lex specialis*, ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik të ndryshuar” *strictu senso* parashikohet se ankimi administrativ pranë autoritetit kontraktor dorëzohet me shkrim *brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.* Në rastin konkret KPP konstaton se, ky i fundit është njoftuar mbi vendimin e KVO-së për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “AlbBuilding” shpk më datë 23.03.2017. Në interpretim të nenit 63 pika 2 të *lex specialis*, afati i ankimit pranë autoritetit kontraktor mbi kundërshtimin e vendimit të mësipërm nis të nesërmen e punës dhe përfundon në ditën e shtatë. Referuar materialeve të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrative, KPP konstaton se operatori ekonomik ankimues në lidhje me pretendimet e mësipërme nuk ka ezuaruar ankim administrativ pranë autoritetit kontraktor në respekt të nenit 63 pika 2 të *lex specialis* si një shkallë e parë e ankimit administrative, por ka parashtruar pretendime vetëm pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ankesa e dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues pranë K.P.P. në lidhje me pretendimet e mësipërme nuk ka respektuar shkallët e ankimit sikurse përcaktohet në ligjin e sipërcituar,

çka rrjedhimisht sjell si pasojë që ai të mos ketë përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimimit, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga “elementet e domosdoshëm të ankesës” që, referuar nenit 23, pikës 3, shkronja “a”, të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 *“Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, ndaj dhe përbën shkak për moshqyrtimin e tyre nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, për shkak të mosrespektimit të afateve të ankimimit. Komisioni Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij se, për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (ndër to dhe ai i ankimimit), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën. Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimitimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues pranë Komisionit të Prokurimit Publik nuk mund të konsiderohet si ezaurim i afateve ligjore që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimuesit, ankimimi nuk është realizuar sipas kriterëve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*. Sa më sipër, KPP gjykon se e drejta e ankimit për kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Albuilding” shpk për pretendimet e sipërcituara, për shkak se nuk është ezauruar pranë autoritetit kontraktor ka rënë në dekadencë.

Sa më sipër pretendimet e mësipërme të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues nuk merren në shqyrtim.

III.2. Referuar materialeve të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, parashtrimeve me shkrim të ankimuesit dhe informacionit të autoritetit kontraktor, KPP konstaton se krahas dorëzimit të formularit të ankesës drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues ka dorëzuar gjithashtu edhe Formularin e Ankesës dorëzuar pranë Autoritetit Kontraktor i cili është i njëjtë me Formularin dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dorëzuar nga ky i fundit, pjesë e informacionit, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ. Referuar formularit të ankesës dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik krahasuar me pretendimet parashtruar pranë autoritetit kontraktor, KPP konstaton se nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, në ankesën dorëzuar pranë KPP-së, nuk ka parashtruar pretendimin e ngritur pranë autoritetit kontraktor në të cilin ka parashtruar argumentin se *“Në kundërshtim me pikën 2.3.7. të kriterëve të veçanta për kualifikim -Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo cdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese. Kur janë me qera, duhet të paraqitet kontrata e qerave, kontrata e blerjes apo cdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese. Operatori ekonomik i kualifikuar në vendin e parë nuk i ka të gjitha kapacitetet teknike të kërkuara dhe nuk disponon të gjithë*

dokumentacionin e kërkuar për këto kapacitete.” Në shtocjën 10 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” të procedurës së prokurimit objekt ankimi, “Kapaciteti Teknik”, pika 2.3.7. KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka parashikuar disponueshmërinë e një sërë makinerish dhe paisjesh duke i ndarë ato në mjete/makineri/paisje që shënohen në regjistrat publikë dhe që nuk shënohen në regjistrat publikë. Referuar natyrës juridike të tyre, autoriteti kontraktor ka parashikuar dhe llojin e dokumentacionit ligjor i cili duhet dorëzuar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës si më poshtë vijon : *“Për paisjet teknike, kur janë në pronësi, duhet të paraqiten faturat tatimore të shitjes dhe kontratat e shitblerjes. Kur janë me qera duhet të paraqiten kontratat e qerave, faturat tatimore të shitjes dhe kontratat e shitblerjes. Faturat që nuk janë sipas formatit të miratuar me tvsh (faturat e biznesit të vogël) duhet të shoqerohen me kuponin tatimor.*

□ Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikata e vlefshme e Dokumenta Standarde të Tenderitkontrollit teknik, siguracioni i vlefshëm i mjetit dhe fotot e tyre. Kur janë me qera, duhet të paraqitet kontrata e qerave, dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik, siguracioni i vlefshëm i mjetit dhe fotot e tyre.

□ Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo cdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese. Kur janë me qera, duhet të paraqitet kontrata e qerave, kontrata e blerjes apo cdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese.”

Referuar ankesës së dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, KPP konstaton se bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues ka parashtruar pretendime mbi mosplotësimin e kriterit të sipërcituar nga ana e operatorit ekonomik “AlbBuilding” shpk në lidhje me disponueshmërinë e mjeteve që nuk shënohen në regjistrat publikë, ndërkohë pranë Komisionit të Prokurimit Publik ka parashtruar pretendime në lidhje me disponueshmërinë e mjeteve të cilat shënohen në regjistrat publikë (një pretendim i ndryshëm), ndërkohë nuk ka parashtruar pretendime lidhur me mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë. Sa më sipër, KPP gjykon se është në të drejtë operatorit ekonomik ankimues, të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të plotë ose të pjesshme në ankimin dorëzuar pranë KPP-së dhe si pasojë mos shqyrtimin e tyre nga e Komisionit të Prokurimit Publik për shkak të mungesës së objektit të gjykimit.

Sa më sipër për pretendimin e mësipërm nuk ka objekt gjykimi për shkak të heqjes dorë.

III.3. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues për kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “AlbBuilding” shpk me argumentin se : *“se “iii. Në kundërshtim me pikën 2.3.8. të kriterëve të veçanta për kualifikim- Makinerite e mesiperme nuk duhet të jene te angazhuara ne kontrata te tjera. Per kete te paraqitet nje deklarate nga administratori i shoqerise ofertuese se makinerite e mesiperme nuk jane te angazhuara ne kontrata te tjera.- Operatori ekonomik i*

kualifikuar në vendin e parë sipas dijenisë tonë makineritë i ka të angazhuara në kontrata të tjera” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 10 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” të procedurës së prokurimit objekt ankimi, “Kapaciteti Teknik”, pika 2.3.8 është parashikuar se “Makinerite e mesiperme nuk duhet te jene te angazhuara ne kontrata te tjera. Per kete te paraqitet nje deklarate nga administratori i shoqerise ofertuese se makinerite e mesiperme nuk jane te angazhuara ne kontrata te tjera.”

III.3.2. Për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “AlbBuilding” shpk ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) dokumentacionin e mëposhtëm:

- i. Deklaratë “Makineritë e deklaruar në shtojcën 9 nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe do të jenë të angazhuara për projektin me objekt “Rikonstruksion i Rrugës Fushë Krujë-Thumanë” gjatë gjithë kohës së zbatimit të projektit.”

III.3.3. Në ankesën drejtuar pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues nuk parashtrojnë fakte apo dyshime të bazuara, por ngrejnë pretendime a-priori se mjetet dhe makineritë e deklaruar pranë autoritetit kontraktor nga ana e operatorit ekonomik “Albuilding” shpk janë të angazhuara në kontrata të tjera. Në ankesën drejtuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik ankimues ka ngritur pretendimin se këto mjete janë të angazhuara në kontrata të lidhura me institucionin e Operatorit të Shpërndares së Energjisë Elektrike Sh.a. pa identifikuar kontratën/kontratat përkatëse.

III.3.2. Referuar Vendimit nr. 184, datë 17.03.2010 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitetit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshëm të ankesës” sipas përcaktimeve të nenit 17, “Forma dhe përmbajtja e ankesës”, pika 3:

- Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni;”

III.3.3. Bazuar në sa mësipër, KPP gjykon se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimuesi duhet të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicje dhe argumenta ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej kjo ankesë. Vlen të ritheksojmë se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrative, i cili në kuptim të nenit 52 të LPP dhe nenit 64 e 65 të VKM nr. 914, datë 29.012.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e Autoritetit Kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik.

III.3.4. Operatori ekonomik e ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij për mospërmbushjen e kriterit/kritereve nga ana e operatorëve ekonomikë të tjerë. Theksojmë se mospërmbushja e kriterit mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërmbushje kriteri/kriteresh.

III.3.5. Komisioni i Prokurimit Publik thekson dallimin e qartë – në gjykimin e tij, ndërmjet një pretendimi të një operatori ekonomik që ngre shqetësim mbi vlerësimin hipotetikusht të gabuar të ofertës së vetë atij nga ana e autoritetit kontraktor, nga njëra anë dhe, pretendimit/prendimeve të këtij operatori apo të cilitdo operatori pjesmarrës në një procedurë prokurimi publik ndaj mënyrës së vlerësimit të autoritetit kontraktor për operatorët e tjerë konkurrentë në këtë procedurë, nga ana tjetër.

III.3.6. Në rastin e parë, kur interesi është absolut dhe i drejtpërdrejtë, barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të autoritetit, ndonëse sërish qëndron mbi ankimuesin, në gjykimin e KPP është arsyeshmërisht më e lehtë. KPP e mirëkupton pozitën e operatorit dhe, në kuptim të misionit të tij për të siguruar efencën e procedurave të prokurimit publik, përmes nxitjes së pjesmarrjes së operatorëve ekonomikë, vlerëson se duhet të adoptojë një qëndrim pro-aktiv, në krah të operatorit ankimues. Në rastin e dytë, kur operatori pjesmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi kurrizin e pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion re-aktiv, në pritje të argumenteve të plotë provues se përse vlerësimi i autoritetit kontraktor ka qenë i gabuar, sipas ankimuesit.

III.3.7. Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicje të qarta, përpara tij, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cënon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

III.3.8. KPP është paraparë nga ligji si një quasi gjykatë. Si e tillë në vendimarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cila thekson faktin se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime të paarsyeshme.

III.3.9. Gjithashtu, në lidhje me pretendimin e mësipërm të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, KPP në vijimësi të praktikës së tij ka mbajtur qëndrimin se thjesht e vetëm fakti i evidentuar se një operator ekonomik është shpallur fitues edhe në disa kontrata të tjera nuk mund të shbëjë deklaratën e administratorit të shoqërisë “për angazhimin e mjeteve të deklaruara në rast se shpallet fitues për proceurën e në fjalë dhe aq më pak të shërbejë automatikisht si shkak skualifikimi. *Inter allia* dhe *mutatis mutandis* në vendimin KPP 459/2014 datë 07.08.2014 në paragrafin III.8.3. të arsyetimit të vendimit të mësipërm, KPP ka arsyetuar se “Komisioni i Prokurimit Publik gjykonë se operatori ekonomik “Bami” shpk ka paraqitur dokumentacionin në përputhje me kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor. Thjesht e vetëm fakti i evidentuar nga autoriteti kontraktor se ky operator ekonomik është shpallur fitues edhe në disa kontrata të tjera (me vlerë relativisht disa herë më të vogël se vlera e kontratës në fjalë), nuk mund të shbëjë deklaratën e administratorit të shoqërisë “Bami” shpk për angazhimin e mjeteve të deklaruara në rast se shpallet fitues për proceurën e në fjalë dhe aq më pak të shërbejë automatikisht si shkak skualifikimi, i pambështetur nga asnjë procedurë verifikimi në realitet. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetë cilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje se, referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e punimeve është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Sa mësipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Bami” shpk qëndron.”

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues për kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “AlbBuilding” shpk me argumentin se “Në kundërshtim me pikën 2.3.1. të kriterëve të veçanta të kualifikim- 2.3.1 Operatori Ekonomik duhet te kete realizuar punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50% e vleres se fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë tri viteve të fundit, është jo më pak se 200% e vleres se fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Plotësimi i njërit prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese formularet e vleresimit sipas shtojces perkatese te DST te shoqeruar me kontraten/kontratat e nenshkruara nga palet, situacionet perfundimtare, aktet e kolaudimit dhe faturat tatimore perkatese. Operatori ekonomik i kualifikuar në vendin e parë nuk i ka të rregullta të gjitha dokumentet e kërkuara për punën e ngjashme” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtocjën 10 *“Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”* të procedurës së prokurimit objekt ankimi, *“Kapaciteti Teknik”*, pika 2.3.1 është parashikuar se *“2.3 Kapaciteti teknik:*

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet te kete realizuar punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50% e vleres se fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

ose

punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë tri viteve të fundit, është jo më pak se 200% e vleres se fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

Plotësimi i njërit prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese formularet e vleresimit sipas shtojces perkatese te DST te shoqeruar me kontraten/kontratat e nenshkruara nga palet, situacionet perfundimtare, aktet e kolaudit dhe faturat tatimore perkatese

III.4.2. Për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “AlbBuilding” shpk ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) dokumentacionin e mëposhtëm:

- i. Kontratë datë 13.04.2011 Lidhur midis Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve, Ministra e Punëve Publike dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive Green Line General Trading & Contrating Co W.L.L. & Contracting Co (W.L.L.) e lidhur me date 13.04.2011 me vlerë kontrate X,XXX,XXX Euro pa TVSH me objekt " By Pass i Durrësit" shoqëruar me situacionet dhe Proces-Verbal i Marrjes ne Dorezim date 30.04.2015
- ii. Kontrate date 13.04.2011 lidhur midis shoqërisë “AlbBuilding” shpk dhe “Green Line General Trading & Contrating Co” W.L.L, ne te cilën GreenLine deklaron se te gjithë pjesën prej XX.XX % te kontratës ja nenkontrakton Albbuilding.
- iii. Formular Vleresimi lëshuar nga shoqëria Green Line General Trading për Albbuilding për punime në vlerë X,XXX,XXX.XX Euro.
- iv. Referencë Punimesh datë 20.03.2016 lëshuar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar për shoqërinë “AlbBuilding” shpk në të cilën deklarohet se *“ Shoqëria “Albuilding” shpk është nënkontraktore e GeenLine General Trading & Contracting Company ny W.LL për projektin “Contruction by Pass Durrës Phase II” me vlerë totale të punimeve të përfunduara X,XXX,XXX Euro. “AlbBuilding” shpk ka përfunduar punimet sipas projektit ku përfshihen edhe punimet civile si më poshtë “ Ndërtim pilota 0=1200 mm me thellësi 32 m; Punime gërmimi dhe mbushje me prezencë të ujrave nëntokësore; Punime betoni bazamentesh në prezencë të ujrave nëntokësore; Punime betoni superstrukture; Punime mure mbajtëse dhe mbushje; Punime shtresash. Punimet janë kryer gjatë periudhës 14/04/2011 deri në 03.04.2015 dhe janë marrë në dorëzim 30.04.2015 konform projektit në përputhje me grafikun e punimeve dhe me cilësinë e kërkuar specifikimet teknike.*
- v. Fatura Tatimore nr.X datë 31.01.2014 lëshuar nga nënkontraktori “AlbBuilding” shpk për shoqërinë “Green Line” me vlerë pa TVSH XX,XXX,XXX lekë pa TVSH;

- vi. Fatura Tatimore nr.X datë 28.02.2014 lëshuar nga nënkontraktori “AlbBuilding” shpk për shoqërinë “Green Line” me vlerë pa TVSH XX,XXX,XXX lekë pa TVSH;
- vii. Fatura Tatimore nr.X datë 31.03.2014 lëshuar nga nënkontraktori “AlbBuilding” shpk për shoqërinë “Green Line” me vlerë pa TVSH XX,XXX,XXX lekë pa TVSH;
- viii. Fatura Tatimore nr.XX datë 30.04.2014 lëshuar nga nënkontraktori “AlbBuilding” shpk për shoqërinë “Green Line” me vlerë pa TVSH XX,XXX,XXX lekë pa TVSH;
- ix. Fatura Tatimore nr.XX datë 30.05.2014 lëshuar nga nënkontraktori “AlbBuilding” shpk për shoqërinë “Green Line” me vlerë pa TVSH XX,XXX,XXX lekë pa TVSH;
- x. Fatura Tatimore nr.XX datë 30.06.2014 lëshuar nga nënkontraktori “AlbBuilding” shpk për shoqërinë “Green Line” me vlerë pa TVSH XX,XXX,XXX lekë pa TVSH;
- xi. Fatura Tatimore nr.XX datë 31.07.2014 lëshuar nga nënkontraktori “AlbBuilding” shpk për shoqërinë “Green Line” me vlerë pa TVSH XX,XXX,XXX lekë pa TVSH;
- xii. Fatura Tatimore nr.XX datë 31.08.2014 lëshuar nga nënkontraktori “AlbBuilding” shpk për shoqërinë “Green Line” me vlerë pa TVSH XX,XXX,XXX lekë pa TVSH;
- xiii. Fatura Tatimore nr.XX datë 30.09.2014 lëshuar nga nënkontraktori “AlbBuilding” shpk për shoqërinë “Green Line” me vlerë pa TVSH XX,XXX,XXX lekë pa TVSH;
- xiv. Fatura Tatimore nr.XX datë 31.10.2014 lëshuar nga nënkontraktori “AlbBuilding” shpk për shoqërinë “Green Line” me vlerë pa TVSH XX,XXX,XXX lekë pa TVSH;
- xv. Fatura Tatimore nr.XX datë 30.11.2014 lëshuar nga nënkontraktori “AlbBuilding” shpk për shoqërinë “Green Line” me vlerë pa TVSH XX,XXX,XXX lekë pa TVSH;
- xvi. Fatura Tatimore nr.XX datë 30.12.2014 lëshuar nga nënkontraktori “AlbBuilding” shpk për shoqërinë “Green Line” me vlerë pa TVSH XX,XXX,XXX lekë pa TVSH;
- xvii. Fatura Tatimore nr.XX datë 31.01.2015 lëshuar nga nënkontraktori “AlbBuilding” shpk për shoqërinë “Green Line” me vlerë pa TVSH XX,XXX,XXX lekë pa TVSH;
- xviii. Fatura Tatimore nr.XX datë 28.02.2015 lëshuar nga nënkontraktori “AlbBuilding” shpk për shoqërinë “Green Line” me vlerë pa TVSH XX,XXX,XXX lekë pa TVSH;
- xix. Fatura Tatimore nr.XX datë 31.03.2015 lëshuar nga nënkontraktori “AlbBuilding” shpk për shoqërinë “Green Line” me vlerë pa TVSH XX,XXX,XXX lekë pa TVSH;
- xx. Fatura Tatimore nr.XX datë 30.04.2015 lëshuar nga nënkontraktori “AlbBuilding” shpk për shoqërinë “Green Line” me vlerë pa TVSH XX,XXX,XXX lekë pa TVSH;
- xxi. Fatura Tatimore nr.XX datë 29.05.2015 lëshuar nga nënkontraktori “AlbBuilding” shpk për shoqërinë “Green Line” me vlerë pa TVSH XX,XXX,XXX lekë pa TVSH;

III.4.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese aftësia teknike: *b) operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet*

organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.4.4. Në nenin 26 “Kontratat e Punëve Publike” pika 6 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, parashikohet se

“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë dhe çdolloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi vërtetime ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdolloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

III.4.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me punimet objekt prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit.

III.4.6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike nga ana e operatorit ekonomik “ Albuilding” shpk në drejtim të plotësimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit mbi dëshminë e eksperiencës së ngjashme, KPP konstaton se është dorëzuar një

kontratë lidhur më datë 13.04.2011 midis Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve, Ministra e Punëve Publike dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive Green Line General Trading & Contrating Co W.L.L. & Contracting Co (W.L.L.) e lidhur me date 13.04.2011 me vlerë kontrate X,XXX,XXX Euro pa TVSH me objekt " By Pass i Durrësit" shoqëruar me situacionet dhe Proces-Verbal i Marrjes ne Dorezim date 30.04.2015. Gjithashtu, krahas saj, konstatohet së një prej anëtarëve të bashkimit të shoqërive Green Line General Trading & Contrating Co W.L.L. & Contracting Co (W.L.L.) të cilat shfaqen në cilësinë e kontraktuesit me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, ka lidhur një kontratë nënkontraktimi me shoqërinë "AlbBuilding" shpk më datë 13.04.2011 ne te cilën Green Line General Trading deklaron se te gjithë pjesën prej XX.XX % te kontratës ja nenkontrakton Albuilding. Në përfundim të punimeve KPP konstaton se kontraktuesi Green Line General Trading ka lëshuar Formular Vleresimi lëshuar nga shoqëria Greenline per Albbuilding për punime në vlerë X,XXX,XXX.XX Euro. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se kontrata e mësipërme e nënkontraktimit është pranuar nga ana e investitorit (autoritetit kontraktues) sot Autoriteti Rrugor Shqiptar i cili në datën 20.03.2016 ka lëshuar Referencë Punimesh për shoqërinë "AlbBuilding" shpk . Referuar referencës së mësipërme, ndër të tjera deklarohet se " *Shoqëria "Albuilding" shpk është nënkontraktore e GeenLine General Trading & Contracting Company ny W.LL për projektin "Contruction by Pass Durrës Phase II" me vlerë totale të punimeve të përfunduara X,XXX,XXX Euro. "AlbBuilding" shpk ka përfunduar punimet sipas projektit ku përfshihen edhe punimet civile si më poshtë " Ndërtim pilota 0=1200 mm me thellësi 32 m; Punime gërmimi dhe mbushje me prezencë të ujrave nëntokësore; Punime betoni bazamentesh në prezencë të ujrave nëntokësore; Punime betoni superstrukture; Punime mure mbajtëse dhe mbushje; Punime shtresash. Punimet janë kryer gjatë periudhës 14/04/2011 deri në 03.04.2015 dhe janë marrë në dorëzim 30.04.2015 konform projektit në përputhje me grafikun e punimeve dhe me cilësinë e kërkuar specifikimet teknike.* "

III.4.7. Në rastin konkret, KPP gjykon se *ratio legis* e nenit 46 pika 1 gërma "b" e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, është vërtetimi i eksperiencës së mëparshme të operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit. Megjithëse përfituesi i punimeve (investitori) është një institucion juridik publik, KPP konstaton se dëshmia e eksperiencës së mëparshme është dorëzuar me anë të kontratës së lidhur me një subjekt juridik privat në cilësinë e nënkontraktorit të punimeve, nënkontraktim i njohur ligjërisht për të cilin është lëshuar edhe referencë punimesh nga investitori. Në respekt të nenit 26 pika 6 të aktit nënligjor në zbatim të ligjit në të cilën parashikohet se "Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi vërtetime ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdolloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve." _operatori ekonomik "Albbuilding" shpk ka dorëzuar në SPE krahas kontratës së lidhur me subjektin juridik privat (GreenLine) ka dorëzuar njëherazi edhe proces verbalin e kolaudimit datë 30.04.2015, proces-verbalin e marrjes në dorëzim të objektit datë 30.04.2015, referencë

punimesh lëshuar nga kontraktori (GreenLine) dhe nga investitori (ARRSH) në cilësinë e dokumentacionit të parashikuar nga ligji në fuqi për vërtetimin për përmbushjen me sukses të punimeve. Gjithashtu, konstatohet se shoqëria “AlbBuilding” shpk ka dorëzuar edhe faturat tatimore lëshuar nga ky i fundit për shoqërinë Green Line General Trading. Gjithashtu, ankimuesi, në plotësim të kriterëve të veçanta të kualifikimit, krahas dorëzimit të kontratës dhe aktit të kolaudit ka dorëzuar edhe faturat tatimore të lëshuara për kontraktorin. Sa më sipër, KPP gjykon se krahas respektimit të parimeve dhe normave juridiko-civile me karakter të përgjithshëm dhe të posaçëm që përmbahen në Kodin Civil, në lidhje me marrëdhënien juridike kontraktuale, kur palë janë persona juridikë privatë që kanë cilësinë e “personit të tatueshëm” sipas legjislacionit fiskal, duhet të gjejnë zbatim dhe të respektohen rigorozisht rregullimet ligjore normative edhe të këtij legjislacioni përsa i përket kushteve dhe mënyrës së përmbushjes së detyrimit mes palëve. Sa më sipër, KPP konstaton se krahas dorëzimit të kontratës, pala ankimuese ka dorëzuar njëherazi edhe fatura tatimore të lëshuara në përputhje me legjislacionin tatimor, Gjithashtu, KPP konstaton, se megjithëse kontrata e mësipërme është lidhur në një datë më të hershme se afati tre vjeçar i dëshmisë së eksperiencës së mëparshme të kërkuar nga autoritetit kontraktor, konstatohet (referuar aktit të kolaudit), se punimet kanë përfunduar më datë 30.04.2015. Ndërkohë, K.P.P. konstaton se procedura e prokurimit objekt akimi është publikuar në datën 08.02.2017 në S.P.E. dhe është zhvilluar në datën 03.03.2017. Gjithashtu shoqëria ka dorëzua edhe faturat tatimore përkatëse me anë të të cilave provohet se shoqëria ka kryer punime në vitet 2014,2015. Gjithashtu, referuar vlerës së punimeve të faturuara gjatë tre viteve të fundit, vlera e faturuar është XXX,XXX,XXX lekë pa TVSH, një vlerë disa herë më e madhe se vlera e kërkuar në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi (50 % e vlerës së fondit limit pa përfshirë vlerën e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar).

Sa më sipër, KPP gjykon se në respekt të nenit 26 “Kontratat e Punëve Publike”, pika 6 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik “AlbBuilding” shpk ka dorëzuar në SPE kontratën e lidhur mes palëve, aktin e kolaudit në të cilën vërtetohet kryerja me sukses e punimeve, vlera dhe kohëzgjatja e punimeve, si edhe fatura tatimore, dhe dëshmi (vërtetim të lëshuar nga investitori), për kryerjen e punimeve, dokumentacion i cili provon plotësimin e kapacitetit teknik , dëshmi e eksperiencës së më parshme në përputhje me kriteret e veçanta të kualifikimit dhe parashikimeve ligjore në fuqi.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë votash

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomik “Bami” shpk & “Geci” shpk për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me objekt *“Rikonstruksioni i rruges Fushe Kruje-Thumane”* me Nr. REF-66979-02-08-2017 me fond limit 741.333.333 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 03.03.2017 nga autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 758 Protokolli; Datë 14.04.2017;

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Leonard Gremshi	Hektor Balluku	Kleves Janku	Odise Moçka
			
Kryetar			
Evis Shurdha			

Mendim kundër

Unë Kleves Janku, anëtar i Komisionit të Prokurimit Publik, parashtroj me shkrim mendimin tim kundër, për t'ia bashkëngjitur vendimit përfundimtar të Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me shqyrtimin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomike “Bami” shpk & “Geci” shpk me objekt Shfuqizimin e vendimit KVO-së për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Alb Building” shpk në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me objekt “Rikonstruksioni i rruges Fushe Kruje-Thumane” me Nr. REF-66979-02-08-2017 me fond limit 741.333.333 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 03.03.2017 nga autoriteti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Nga shqyrtimi i materialit të administruar, parashtrimeve me shkrim të ankimuesit si edhe informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor vërej se:

I. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues për kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Alb Building” shpk me argumentin se “Në kundërshtim me pikën 2.3.1. të kriterëve të veçanta të kualifikimit- 2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të ketë realizuar punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50% e vlerës së fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë tri viteve të fundit, është jo më pak se 200% e vlerës së fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Plotësimi i njërit prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese formularet e vleresimit sipas shtojces perkatese te DST te shoqeruar me kontraten/kontratat e nenshkruara nga palet, situacionet perfundimtare, aktet e kolaudit dhe faturat tatimore perkatese. Operatori ekonomik i kualifikuar në vendin e parë nuk i ka të rregullta të gjitha dokumentet e kërkuara për punën e ngjashme” Konstatoj se:

- Në shtojcën 10 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” të procedurës së prokurimit objekt ankimi, “Kapaciteti Teknik”, pika 2.3.1 është parashikuar se “2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të ketë realizuar punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50% e vlerës së fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

ose

punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë tri viteve të fundit, është jo më pak se 200% e vlerës së fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

Plotësimi i njërit prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese formularet e vleresimit sipas shtojces perkatese te DST te shoqeruar me kontraten/kontratat e nenshtruara nga palet, situacionet perfundimtare, aktet e kolaudimit dhe faturat tatimore perkatese.

Për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “AlbBulding” shpk ka dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike dokumentacionin e mëposhtëm:

- kontratë datë 13.04.2014 lidhur mes Drejtorisë së përgjithshme të Rrugëve, Ministria e Punëve Publike dhe B.O Green Line General Trading & Contracting Co W.L.L me vlerë kontrate 8 005 500 euro pa tvsh me objekt “By pass I Durrësit shoqëruar me situacionet dhe processverbali I marrjes në dorëzim datë 30.04.2015.
- kontratë datë 13.04.2011 lidhur mes Albubding shpk dhe Green Line General Trading & Contracting Co W.L.L në të cilën Green Line deklaron se të gjithë pjesën 81.63 % të kontratës e nënkontraktton Albubding.
- Formular vlerësimi leshuar nga shoqëria Green Line General për Albubding shpk për punime në vlerë 6 420 534.81 euro si dhe situacione të padatuara mes dy subjekteve në Green Line dhe Albubding shpk.
- Referencë punimesh leshuar nga PIU (project implement unit) njësi administrative e Autoritetit Rrugor Shqiptar që është ngritur për ndjekjen e projektit. Në të cilën deklaron se Shoqëria Albubding shpk është nënkontraktore Green Line Trading...duke përmendur se shoqëria Albubding shpk ka kryer punime Ndërtim pilota 0+1200 mm thellësi si dhe të tjera punime të përmendura në vendimin e komisionit.
- Disa fatura tatimore të leshuara nga Albubding për Greenline Trading të cituara dhe këto në vendimin e shumicës së anëtareve.

Shumica e anëtareve të Komisionit ka gjykuar se me paraqitjen e këtyre dokumentacioneve shoqëria albubding shpk e plotëson kriterin 2.3.1 *Operatori Ekonomik duhet te kete realizuar punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50% e vleres se fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.*

ose

punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë tri viteve të fundit, është jo më pak se 200% e vleres se fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

Plotësimi i njërit prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese formularet e vleresimit sipas shtojces perkatese te DST te shoqeruar me kontraten/kontratat e nenshkruara nga palet, situacionet perfundimtare, aktet e kolaudimit dhe faturat tatimore perkatese.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik Albulding shpk në sistemin elektronik të prokurimeve, evidentohet se nga ana e kësaj shoqërie nuk është paraqitur kontrata bazë e plotë e lidhur ndërmjet sipërmarrësit dhe investitorit (Greenline Trading) në cilësinë e sipërmarrësit dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, Njësia e Menaxhimit të Projekteve, me cilësinë e Punëdhënësit (Investitorit), kontratë kjo që i shërben autoritetit kontraktor për verifikimin e vlefshmërisë së kontratës së nënsipërmarrjes së lidhur ndërmjet sipërmarrësit Green Line dhe shoqërisë “Albulding” sh.p.k. në cilësinë e nënkontraktorit. Lidhur me këtë çështje gjykoj se kontrata bazë është e domosdoshme dhe e nevojshme për të verifikuar kushtet në të cilat është lidhur kjo kontratë, rastet nëse lejohet nënkontraktimi ose jo, miratimi i tij, etj.
- Gjithashtu referuar shtojcës 8 Formulari i vlerësimit të paraqitur nga shoqëria Albulding, në rreshtin Autoriteti kontraktor/investitori, evidentohet nënshkrimi dhe vula nga shoqëria Green Line, e cila në fakt, rezulton të jetë kontraktor dhe sipërmarrës (referuar kontratës së nënsipërmarrjes si edhe informacionit të dhëna nga PMU) dhe jo në rolin e investitorit, në cilësinë e të cilit, është shfaqur në këtë dokument.
- Sa më sipër, sqaroj se nënkontraktimi është një proces për të cilin meret më parë aprovimi dhe miratimi i investitorit, për verifikimin e kushteve përkatëse të lejimit të nënkontratimit dhe verifikimin e vlerës apo pjesës së punëve të dhëna për nënkontraktim, fakt ky i paprovuar nga dokumentacioni I dorëzuar në sistemin e prokurimeve publike.
- Sa më sipër sqaroj se kontrata e nënsipërmarrjes e lidhur ndërmjet Green Line trading dhe “Albulding sh.p.k. nuk është në kushtet e një kontrate të lidhur me subjekt privat, pasi siç shihet kemi të bëjmë me një investim publik dhe është një kontratë nënsipërmarrje që rrjedh nga një kontratë bazë fillestare e lidhur ndërmjet sipërmarrësit dhe Investitorit që në rastin konkret është Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Arsytimi i shumicës së antarëve të Komisionit se kontrata e paraqitur është e realizuar me sektorin privat nuk qëndron, për sa kohë që në çdo moment në kontratën e nënsipërmarrjes evidentohet detyrimi dhe varësia e nënkontraktorit nga Investitori (Punëdhënësi), qoftë në situacionet, volumet e punës, pagesën, dëmet e shkaktuara etj., si më sipër cituar.
- gjykoj se kontrata fillestare e lidhur ndërmjet investitorit dhe sipërmarrësit, është një dokumentacion i domosdoshëm dhe i rëndësishëm, me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikojë realizimin me sukses të kontratës dhe pjesës së marrë përsipër për t’u realizuar.

- Në kushtet kur konstatohet se nga ana e nënkontraktorit është marrë përsipër kryerja e vlerës totale të projektit, për të cilin është lidhur kontrata fillestare ndërmjet sipërmarrësit dhe investitorit, i cili është menaxhuesi dhe financuesi i fondeve, dokumentat e tilla si kontrata fillestare, miratimi i nënkontraktimit, vërtetimi i realizimit me sukses i kontratës nga sipërmarrësi, **janë elementë të cilët nuk janë paraqitur** nga shoqëria Albulding shpk, duke mos vërtetuar përmbushjen me sukses të kriterit për eksperiencat e mëparshme të ngjashme. Paraqitja e këtyre elementëve dhe dokumentave është e rëndësishme dhe e domosdoshme në kushtet kur në kontratën e nënsipërmarrjes është përcaktuar se çdo veprim i nënkontraktorit ose punët e nënkontraktuara duhet të kenë më parë miratimin e investitorit, duke arritur në konkluzionin se është investitori ai që duhet të vërtetojë se ka pranuar realizimin me sukses të punëve të realizuara, pasi investitori është financuesi kryesor dhe i drejtëpërdrejtë i kontratës së paraqitur nga Albulding shpk.
- Referuar paragrafit të mësipërm, jam njohur me kontratën e plotë të lidhur midis Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve(investitori) dhe Green Line Trading(kontraktori), nëpërmjet kërkesës zyrtare drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe kthim përgjigjes së kësaj të fundit kthyer në datë 23.05.2017, konstatoj se në clausolën 4.4 është vendosur që limiti I punëve që mund të nënkontraktohen është jo më shumë se 33 %, duke marrë më parë miratimin e Autoritetit (investitori). Në këtë kontratë nuk përmendet në asnjë moment se shoqëria Albulding është nënkontraktuar për të kryer punë për llogari të sipërmarrësit kryesor.
- Lidhur me letrën e referencës lëshuar nga PIU (njësia e menaxhimit të projekteve) nuk mund të merret në konsideratë, pasi kjo letër reference nuk përmban sasinë dhe volumin e zërave të shprehur në vlerë monetare apo përqindje të kontratës si dhe kjo njësi nuk ka tagër për të lëshuar një dokument të tillë pa miratimin e investitorit siç është shprehur në klauzolën e 4.4 të kontratës së lidhur mes ARSh dhe Green Line Trading ndaj nuk mund të njihen si punë të kryera nga Albulding shpk.

Gjithashtu duke verifikuar dokumentacioni në sistemin e prokurimit publik s.p.e, rezulton se ka një mospërputhje mes proceverbalit të dorëzimit, pra dorëzimi i objektit ndaj investitorit (ARSH), dhe situacioneve që Albulding ka dorëzuar sipërmarrësit kryesor Green Line Trading. Procesverbali I dorëzimit tek investitori mban datën 30.04.2015 kurse situacionet e dorëzuara nga shoqëria Albulding shpk për llogari të sipërmarrësit kryesor mbajnë si datë muajin maj të 2015.

Referuar sa më sipër si dhe në vijimësi të praktikës së të mbajtur nga vet antarët e Komisionit të Prokurimit Publik në **vendimin me nr 822/2016** me objekt “Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e operatorit ekonomik “Alko Impex General Contrucion” d.dh.h., në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-46272-07-29-2016, me objekt: “Përfundimi i rrjetit të Kanalizimeve të Ujrave të Zeza në zonën e Përroi i Agait – Qerret, Loti II (Linjat KUZ Përroi Agait, Stacioni Pompimit Nr.1 deri tek Stacioni Pompimit Nr. 2)”, me fond limit 353.062.840 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 25.08.2016, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve”, “Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e operatorit ekonomik “Gener 2” sh.p.k. nga procedura e mësipërme e prokurimit”,

- duke parë se ndodhemi në të njëjtën situatë objektive dhe me element identik të çështjeve në gjykim, gjykoj se ankimi i bashkimit të operatorëve ekonomike “Bami” shpk & “Geci” shpk për skualifikimin e operatorit Albudling shpk, qëndron.

Lidhur me çështjet e tjera të ngritura nga bashkimi të operatorëve ekonomike “Bami” shpk & “Geci” shpk, gjykoj se nuk është e nevojshme të merren në gjykim, pasi e cilësoj mosplotësimin e kriterit të mësipërm të mjaftueshëm për skualifikimin e operatorit ekonomik Albudling shpk.

Kleves Janku

Anëtar

